



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Tonin Melaj** me datë **24.10.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “**1.** Informacion 2 mujor me shkrim mbi gjëndjen e procedimit. **2.** Ndryshimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në shtëpi” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, e caktuar ndaj personit nën hetim Tonin Melaj me vendimin nr. 81, dt. 21.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, me një masë sigurimi personal më të butë”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 234, 246/6 dhe 260/2 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **604**, datë **21.11.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit (personit nën hetim) **Tonin Melaj**.
2. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “*Arrest në shtëpi*” e parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, e caktuar ndaj personit nën hetim **Tonin Melaj** me vendimin nr. 81, dt. 21.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me masën e sigurimit personal “*Detyrimi për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore*” e parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.
3. Personi nën hetim **Tonin Melaj** detyrohet të paraqitet ne Zyrat e Policisë Gjyqësore, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar të hënën e parë të çdo muaji në orën 12:00.
4. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar dhe shërbimet e policisë gjyqësore me zbatimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 5 ditëve, afat i cili fillon nga dita e njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 21.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar